REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KUÇOVË**
**DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE**

*Nr.* 3992 *Prot.* *Kuçovë më* 21 / 11 /2024

# PROJEKTVENDIM

## Nr. 51 datë. 21.11.2024

## "PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE PËR VITIN 2025"

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 54 pika "f" , te Ligjit Nr .9632 dt.30.10.2006," Për Sistemin e Taksave Vendore ", të ndryshuar, Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore ne R.SH", i ndryshuar, ligjit nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit", ligjit nr.24/2017 "Per Administrimin e Ujitjes e Kullimit" i ndryshuar, ligjin nr.9385 datë 04.05.2005 "Per Pyjet dhe Shërbimin Pyjor" i ndryshuar, ligjit nr 10279 datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet Administrative", dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, duke patur si objektiv për tu arritur, me qëllimin primar : mundësimin e kryerjes se funksioneve dhe përmiresimin sasior dhe cilësor të shërbimeve që i ofrohen komunitetit.

Kjo "Paketë" bazohet kryesisht në treguesit bazë të nivelit te Paketës Fiskale të vitit 2024 per katër Njesitë Administrative; Kuçovë, Kozare, Perondi dhe Lumas.. Krahas ruajtjes së nivelit aktual për disa Taksa dhe Tarifa për abonentet familjar me ndihmë ekonomike,invalid,veteran,pensionist i vetmuar,do të paraqesim ndryshime të moderuara dhe të strukturuara për familjet e tjera dhe për subjektet e biznesit, për të përafruar vlerën e faturuar me koston e shërbimit.

## I. Hyrje

Autoriteti i Qeverisjes Vendore përcaktohet në ***Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*** neni 13, 108-115, 131 dhe 163, nene të cilat përcaktojnë kornizën kryesore të qeverisjes vendore dhe parimet e decentralizimit të njësive të qeverisjes vendore. Në funksion të kësaj autonomie, "***Karta Europiane e Vetëqeverisjes Vendore***" sanksionon autonominë e pushtetit vendor nga pikpamja financiare (neni 9). Mbi këto parime, ligji nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, Kreu VIII i cili trajton *"Financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore"* sanksionon parimet e

financimit te njesive te qeverisjes vendore (neni 54, pika 1). Sipas ligjit 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", neni 34, pika 3 dhe 4, njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qëndrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj. Njësive vendore u garantohet me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur. Gjithashtu, legjislacioni në fuqi u garanton njësive të qeverisjes vendore mjaftueshmërinë financiare dhe diversifikimin e burimeve të të ardhurave. Kështu, ato kanë të drejtë të aplikojnë taksa dhe tarifa vendore, të ardhurat e të cilave shkojnë për financimin e aktivitetit dhe shërbimeve publike që ato ofrojnë. Për funksionet dhe kompetencat që u delegohen njësive të qeverisjes vendore nga institucionet qendrore, pushteti vendor duhet kurdoherë të shoqërohet me mjetet e nevojshme financiare për realizimin e tyre. Ligji Nr 9632, datë 30.10.2006 *"Për sistemin e taksave vendore"* dhe ndryshimet respektive sanksionon kuadrin ligjor bazë për sistemin e taksave dhe tarifave vendore si dhe rregullat bazë në mbledhjen, administrimin dhe në ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore.

Në hartimin e Paketes Fiskale per vitin 2025, si dhe PBA-së për periudhën 2025-2027, në projektimin e treguesve dhe nivelit të taksave dhe tarifave, u morën në konsideratë e përgjithësisht janë ruajtur emërtimet fiskale dhe kategoritë e taksapaguesve të Paketes Fiskale të vitit 2024, miratuar nga Këshilli i Bashkisë Kuçovë. Bazuar në politikën social-ekonomike të ndjekur nga Bashkia Kuçovë, në funksion të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të menaxhimit të shërbimeve bazuar në kosto, adaptuar e miratuar kjo, në nivel vendor nga Këshilli Bashkiak Kuçovë, si dhe në komunikimet me komunitetin në të gjitha njesitë administrative, diskutimet e konsultimet me grupet e interesit dhe në komisionet e ngritura për këtë qëllim në Bashki, për vitin 2025 parashikohen ndryshime të moderuara e të diferencuara të nivelit të taksave dhe tarifave të aplikuara krahasimisht nga ato të përcaktuara në Paketën Fiskale të vitit 2024, duke qënë të kujdesshem për ngarkesën fiskale për subjektet familjare në përgjithësi, e veçanërisht për shtresat në nevojë. Kështu, vlerësimet dhe përpjekjet e administrates së Bashkisë do të orientohen më së shumti në përmirësimin e menaxhimit fiskal, rritjen e efiçencës në mbledhjen e taksave dhe zgjerimin e bazës të taksapaguesve në Bashkinë Kuçovë.

## II. Të dhëna të përgjithshme

Në vijim të implementimit të reformës administrative – territoriale me ligjin Nr. 115/2014 *"Për ndarjen administrativo – territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"* konteksi aktual i Bashkisë Kucove ndërthur një mori traditash, burimesh natyrore, ekonomike dhe infrastrukturore. Ne funksion te kesaj ndarje administrativo- territoriale, Bashkia Kucove, përbëhet nga 4 njësi administrative (shiko tabelën 1) të cilat shtrihen në një sipërfaqe totale prej rreth 160.22 $km^2$.




**Tabelë1.** *Konfigurimi i bashkisë Kucove*

| **BASHKIA** | *NJ.ADMIN* | *QYTETI DHE/OSE FSHATRAT* |
|---|---|---|
| **KUCOVA** | *KUCOVE* | *QYTETI KUCOVE* |
| | *PERONDI* | *Perondi, Magjatë,Tapi, Rreth-Tapi, Goraj, Velagosht, Polovinë* |
| | *KOZARE* | *Havaleas, Kozare, Gege, Drizë,Frashër, Fier-Mimar, Vlashuk, Ferras, Demollarë, Salcë-Kozare,Zdravë* |
| | *LUMAS* | *Lumas, Pashtraj,Mëndrakë,Sheqës,Krekëz,Vodëz, Koritëz,Belesovë,Pëllumbas,Luzaj* |

Burimi: http://www.reformaterritoriale.al/kryesore/harta-me-61-bashki

**Tabelë2.** *Tregues të demografisë sipas njësive administrative*

**PopullsiasipasGjendjes Civile**

| Bashkia | Njësia Administrative | Popullsia | Nr. ifamiljeve |
|---|---|---|---|
| Kuçovë | Kuçovë | 28,208 | 10,861 |
| | Kozare | 8,517 | 2,655 |
| | Perondi | 11,422 | 3,720 |
| | Lumas | 7,001 | 2,300 |
| | **Totali** | **55,148** | **19,536** |

Të dhënat demografike përfaqësojnë një element të rëndësishëm në kuadrin e hartimit të PBA-së. Në të dhënat nga regjistri i Gjendjes Civile për vitin 2024 tregojnë se në total, Bashkia Kuçovë ka një popullsi prej 55 148 banorë, si dhe 19 536 familje.

Shpërndarja e popullsisë tregon për përqëndrim të saj në njësinë administrative Kucove. Kështu, në këtë njësi regjistrohen rreth 28 208 banorë ose rreth 52.3 % e totalit të popullsisë së Bashkisë Kucove. Njësitë administrative Perondi e Kozare regjistruan popullsi duke përfaqësuar respektivitsht rreth 19.8 % dhe 15 % ndaj popullisë totale.

Kuçova ka një dendësi prej 345 banorë/km².

## I. Proçesi i Hartimit të Paketës Fiskale

Për hartimin e Paketës Fiskale janë angazhuar drejtuesit dhe specialistët në Bashkinë Kucove:

- Drejtoria e të Ardhurave Vendore;
- Drejtoria e SherbimevePublike&Transportit;
- Drejtoria e Finances dheBuxhetit;
- Drejtoria e Zhvillimit Rural;
- Drejtoria e Planifikimit të Territorit;
- DrejtoriaJuridikedheProkurimevePublike;
- Qendra Ekonomike e Arsimit;
- Qendra e Kulturës se Bashkise,
- Administratorët e Njësive Administrative.

### Çfarë prezanton Paketa Fiskale:

Në mënyrë të përmbledhur kjo paketë fiskale synon:

a) Hartimin e një Pakete Fiskale të integruar;

b) Rishikimin e kornizës ligjore me qëllim përcaktimin e saktë të taksave, tarifave dhe çdo pagese tjetër që ndikon në buxhetet vendore dhe për të cilat njësia vendore duhet të arkëtojë të ardhura;

c) Saktësimin e proÇedurave, afateve, aktorëve, veprimeve, përgjegjësive për çdo taksë dhe tarifë, pjesë e këtij Pakete Fiskale. Përcaktimi i saktë i të gjithë elementëve të lidhur me menaxhimin do të pasurojë akoma më tej dhe do të vendosë një bazë të fortë për ndërtimin e një sistemi fiskal efiçent dhe transparent;

d) Përcaktimin e qartë dhe ndarjen në seksione të taksave nga tarifat. Çdotaksëdhetarifë do tëdetajohet duke paturnëkonsideratëelementët:

□ Taksimidrejtë;

□ Tarifimmbështeturnëkosto;

□ Klasifikimibiznesit, qarkullimvjetor, llojiiaktivitetit;

□ Qartësimidhepërcaktimiitaksave apo tarifaveqëaplikohenpërkategorinë e familjevenisurngalloji, vendndodhjaetj;

e) Analiza e taksaveqëaplikohenpërterritorinqëmbulonnjësia (mbështeturnëlegjislacioninnëfuqi), përcaktimidhedetajiminëkategori, unifikimiikategorivepërtëgjitha**taksat**, përcaktimiibazëssëtaksueshmedheaplikimiikufijveqëpërcaktonligji;

f)Rikategorizimi dhe detajimi i taksave;

g) Analiza e tarifave që aplikohen për territorin që mbulon njësia (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimi dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha tarifat, përcaktimi i nivelit të tarifave mbështetur në koston e shërbimit për të cilin vendosen;

h) Aplikimi i lehtësirave fiskale për grupe të caktuara taksapaguesish në nevojë, siç parashikon ligji.

## II. Kuadri rregullativ – ligjor :

Kjo Pakete Fiskale, eshte hartuar ne respekt dhe ne zbatim te legjislacionit si vijon :

- Ligji Nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore";
- Ligji Nr. 9632 datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9975/2008, "Për taksat kombëtare" i ndryshuar;

- Ligji Nr. 9936/2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji Nr. 68/2017 "Per Financat e Qeverisjes Vendore"
- Ligji Nr. 10081/2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji Nr. 10296/2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin";
- Ligji Nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit";
- Ligji Nr. 8438/1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8518/1999, "Për Ujitjen dhe Kullimin";
- Ligji Nr. 9920/2008,"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji Nr.115/2014 "Për ndarjen administrativ –territoriale të njësive qeverisjes vendore te R.SH.
- Ligji Nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin";
- Ligji 10465/2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji Nr. 9385/2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor";
- Ligji Nr. 9693/2007, "Për fondin kullosor", i ndryshuar
- Ligji Nr.10463/2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10279/2010, "PërKundravajtjet Administrative";

## TE DHENA TE PERGJITHSHME

Në territorin e Bashkisë KUCOVE, bazuar në të dhënat e vitit 2023, operojnë përafërsisht:

- 603 Biznesetëvogla;
- 97 Biznesi Madh;
- 28 NdërmarrjeInstitucione;
- 19536 familje.

Llogaritjetdheparashikimet e teardhuravepërvitin 2025, do tëkryhenbazuartëdhënavetemësipërme, duke iindeksuar : me numrin e familjevenënevojëtëcilatpërfitojnereduktimtëtaksavedhetarifave, duke përdorurstatistikat e trendittëndryshimittëabonentevefamiljarë (emigracionidhemigrimiibrendshëm), duke analizuarlëvizjendhendryshueshmërinë e numritdheshkallësseaktivitetittësubjektevetëbiznesitqëushtrojnëaktivitetinnëterritorin e BashkisëKuçovë.

Bazuarnëligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 " Përsistemin e TaksaveVendore " indryshuar, dheaktet e tjeranënligjoresektoriale, per vitin 2025, po parashtrojmënëmënyrëanalitikeTaksatdheTarifat me ndryshimet e përkatësesimëposhtë :

## *1. TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME*

Në taksën mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen :
I. Taksa mbi ndertesat,
II. Taksa mbi tokën bujqësore.
III. Taksa mbi truallin

## I. TAKSA MBI NDËRTESAT

Në zbatim të ligjit **nr.106/2017 datë 30.11.2017** "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006,"Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, **V.K.M nr. 132 datë 07.03.2018** "Për Metodologjinë e përcaktimit të vlerës së taksueshmetë pasurisë së paluajtshme**"NDËRTESA"**, Këshilli i Bashkisë **me Vendimin nr.66 date 22.08.2018,** përcaktoi nivelin dhe shkallën e çmimit të references për çdo njesi administrative dhe për kategoritë e pasurisë së paluajtshme "NDËRTESA", nivel që propozojmë dhe për **vitin 2025**, pasi janë të parapara dhe modalitetet e reduktimit sipas ligjit.

Taksës mbi Ndërtesën i nënshtrohen:

1. Individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e bashkisë Kucove, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë paketë përcaktohet ndryshe.
2. Personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".
3. Zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
4. Baza e taksueshme përbëhet nga sipërfaqja ndërtimore në metër katror e ndërtesës ose pjesë të saj, nën dhe mbi nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi të takasapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve të pronësisë, apo në mungesë të tyre, përdoruesi i ndërtesës realizon vetëdeklarim të sipërfaqes pranë Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kucove.Subjekt i taksës mbi ndërtesat janë edhe taksapaguesit, të cilët kanë, në përdorim apo në pronësi, ndërtesa brenda territoreve të miratuara si fshatra turistike. Sipërfaqja e ndërtesës, në përdorim apo pronësi, përcaktohet në bazë të dokumenteve, që vërtetojnë përdorimin ose pronësinë e saj.
5. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e taksueshme. Për tatimpaguesit që kanë në pronësi më shumë se një banesë, për shtëpinë ku kanë banim të zakonshëm të cilën e vendosin me vetëdeklarim, paguajnë taksën e ndërtesës sipas tabelës 4. Ndërsa për të gjitha shtëpitë e tjera, taksa e ndërtesës është sa dyfishi i taksës së ndërtesës që zbatohet.

6. Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuara për shitje, por që janë ende të pashitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndërtesës. Ambientet e hipotekuara si:

   a. *Apartamente banimi do t'i nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë e parë, "ndërtesa banimi";*
   b. *Ndërtesë biznesi do t'i nënshtrohet taksës mbi ndërtesat në kategorinë "ndërtesa të tjera për tregti dhe shërbimi".*

7. *Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor. Afati i pagesës për detyrime të lindura gjatë vitit është 30 ditë kalendarike pas datës së lindjes së detyrimit, dhe në propocion me ditët e mbetura deri në fund të vitit.*

8. **Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat**:

   a) Pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;

   b) Ndërtesat e banimit që shfrytëzohen nga qiramaresi me qira të paliberalizuara;

   c) Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare në funksion të veprimtarisë së tyre;

   d) Banesat sociale në pronësi të bashkisë;

   e) Pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;

   f) Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;

   g) Familjet të cilëve ju ka vdekur kryefamiljari dhe fëmijët janë në moshë të mitur, nuk zotërojnë aktivitet privat, apo pasuri të luajtshme ose të pa luajtshme nga të cilat përfitojnë të ardhura.

   h) Strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";

   i) Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët, ose dhe me familjare me statusin e personit me aftesi te kufizuara

   j) Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;

   k) Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore.

9. Për të përfituar nga përjashtimi, këto familje duhet të dorëzojnë pranë Drejtorise se te Ardhurave dokumentet e mëposhtëm, të lëshuara nga zyrat përkatëse, brenda muajit në të cilin dorëzohen dokumentat:

   1) Librezën përkatëse te pensionit

   2) Vërtetimin e papunësisë nga zyra e punës të lëshuar brenda muajit që dorëzohen dokumentat;

   3) Vërtetimin e përfitimit të ndihmës ekonomike të plotë apo të pjesshme;

   4) Çertifikatë familjare.

Nivelet e taksës mbi ndërtesat sipas kategorive dhe nënkategorive përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme : Për katër Njesite Administrative do të jetë si më poshtë

| | Njësia | KUCOVA 100% | | KOZARE -30 | | PERONDI - -30 | | LUMAS-35% | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **LlojiTaksës/Tarifës** | **matëse** | **cmimi** | **shkalla** | **cmimi** | **shkalla** | **cmimi** | **shkalla** | **cmimi** | **shkalla** |
| **I. Ndërtesabanimi** | leke | 36000 | 0.05% | | | | | | |
| a. banesa para vitit '93 | | 36000 | 0.035% | 25200 | 0.035% | 25200 | 0.035% | 23400 | 0.035% |
| b. banesa privatiz me ligj 7652 dt.23.12.1992 | leke | 25200 | 0.035% | 17640 | 0.035% | 17640 | 0.035% | 16380 | 0.035% |
| **II. Ndërtesatëtjera** | | | | | | | | | |
| a.Veptregtimi&sherbimi | Leke | 54000 | 0.140% | 37800 | 0.140% | 37800 | 0.140% | 35100 | 0.140% |
| b.Parkimmbuluar | leke | 25200 | 0.035% | 17640 | 0.035% | 17640 | 0.035% | 16380 | 0.035% |
| c.Bodrume | Leke | 25200 | 0.035% | 17640 | 0.035% | 17640 | 0.035% | 16380 | 0.035% |
| d.Parkim I Hapur | Leke | 10800 | 0.035% | 7560 | 0.035% | 7560 | 0.035% | 7020 | 0.035% |
| e.Prodhim,perpunim, magazinim | leke | 18000 | 0.140% | 12600 | 0.140% | 12600 | 0.140% | 11700 | 0.140% |
| f.Sip.ndertimi bujqesi, blegtori | leke | **10800** | 0.140% | 7560 | 0.140% | 7560 | 0.140% | 7020 | 0.140% |

- Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokëes dhe për çdo kat.

Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë këtë pronësi, ose përdorim, vetëdeklarimit apo metodave alternative të parashikuara në ligj

- Taksa mbi ndërtesat për kategorinë **I "Ndërtesa Banimi"** (nga familjet) paguhet për çdo ndërtesë që qytetari ka në pronësi.
- Taksa mbi ndërtesat për kategorinë **II "Ndërtesa të tjera"** , paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitet.

**Agjenti Tatimor**

- Agjent tatimor për vjeljen e taksës mbi ndërtesën për kategorinë, **I. "Ndërtesa Banimi"** , si dhe kategorinë **II. "Ndërtesa të Tjera"**, është Ujësjellësi UKRB,e cila është një shoqëri me shtrirje territoriale në të gjithe territorin e Bashkisë Kuçovë dhe me garanci për arkëtimin e kësaj takse.

**Afatet e pagesës**

- Për kategorinë **I "Ndërtesa Banimi"** , ", si dhe kategorinë **II. "Ndërtesa të Tjera"** në vendimin e Këshilli te Bashkisë, propozohet qe faturimi dhe arkëtimi i kësaj takse **te jete mujor**(ndarë propocionalisht për 12 muaj), dhe vlera të jetë e integruar në faturën mujore të lëshuar nga UKRB SHA.

- Për familjarët të cilët nuk kanë kontratë me UKRB SHA në Njësite Administrative **Kozare, Lumas e Perondi**, faturimi dhe arkëtimi do të bëhet nga administrata e Njësive respektive, inkorporuar ne faturën e detyrimeve vjetore familjare, jo më vonë **se 30 shtatori 2024**

- Për kategorinë kategorinë **I "Ndërtesa Banimi"** dhe **II "Ndërtesa të tjera"**, të cilët nuk kanë kontratë furnizimi me UKRB SHA është paraparë që afati i pagesës të jetë **30 Shtator 2024**

**Penalitetet**

- Shkeljet e dispozitave për taksën e ndërtesës,që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënimet përkatëse përcaktohen me ligjin nr,9920, datë 19.05.2008 "Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"

## II. TAKSA MBI TOKEN BUJQESORE

Për vitin 2024 mbi bazën e të dhënave për sipërfaqen e tokave bujqësore dhe pronarëve respektive, si dhe bazuar në nivelin e kësaj Takse, që jepet ne Nenin 23 ( sipas aneksit 2, bashkëngjitur) te ligjit "Për Taksat Vendore" nr.9632 date 30.10.2006, kemi këtë tabelë të çmimeve referuese sipas kategorive:

| Taksa e Tokes Bujqesore | Njesia matese | KUCOVA | | KOZARE | | PERONDI | | LUMAS | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 |
| Kategoriae I | Leke/ha/vit | 4620 | 4620 | 4200 | 4200 | 4200 | 4200 | 4200 | 4200 |
| Kategoriae II | Leke/ha/vit | 3850 | 3850 | 3500 | 3500 | 3500 | 3500 | 3500 | 3500 |
| Kategoriae III | Leke/ha/vit | 3080 | 3080 | 2800 | 2800 | 2800 | 2800 | 2800 | 2800 |
| Kategoriae IV | Leke/ha/vit | 2530 | 2530 | 2300 | 2300 | 2300 | 2300 | 2300 | 2300 |
| Kategoriae V | Leke/ha/vit | 2090 | 2090 | 1900 | 1900 | 1900 | 1900 | 1900 | 1900 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Kategoriae VI** | Leke/ha/vit | 1760 | 1760 | 1600 | 1600 | 1600 | 1600 | 1600 | 1600 |
| **Kategoriae VII-X** | Leke/ha/vit | 1540 | 1540 | 1400 | 1400 | 1400 | 1400 | 1400 | 1400 |

- Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore është bërë nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

- Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit.

- Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, ***formulari 6***, akti i pronësisë, çertifikata e regjistrimit të tokës si dhe vetëdeklarimit

- Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore llogaritet si prodhim i sipërfaqes me çmimin sipas kategorisë. Ky detyrim është **vjetor** dhe paguhet **me nje këst të vetëm** deri me 30 shtator 2025.

- Aplikimi i stimulit favorizues: për fermerët që do të paguajnë Tatimin e Tokës Bujqësore brenda 30 Prill 2025, te kete **ulje prej 10 %** te vleres se ketij tatimi vjetor.

**Struktura e** ngarkuar per vjeljen e takses mbi token bujqesore, jane **Njesite** Administrative : ***Administratori i njesise,inspektori i te ardhurave dhe specialisti i bujqesise prane njesive si dhe ne bashkepunim me kryeplakun e fshatit***

## III.TAKSA E TRUALLIT

Taksa e truallit do te aplikohet konform zbatimit te ligjit nr.142/2015 date 17.12.2015 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.9632 date 30.10.2006, "Per Taksat Vendore" I ndryshuar. Ne konceptin sipas ketij ligji, me **termin "Truall"**,perkufizohet nje siperfaqe toke jobujqesore, qe ndodhet brenda vijes kufizuese te ndertimit e percaktuar nepermjet dokumentave ligjore te planifikimit, e miratuar per te ndertuar mbi te. Njeheresh ne ligj theksohet se :" Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen **të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj**, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnëpërjashtimrastetkurnëligjparashikohetndryshe".

a- **Baza** e TaksësmbiTruallin, ështësipërfaqja e truallit ne m2, nëpronësi apo përdorimtëtaksapaguesit, Sipërfaqja e truallitnëpronësi, përcaktohetsipasdokumentaveqë e vërtetojnëatë. Nërasttemungesëssëdokumentacionittëpronësisë, përdoruesibënnjë**vetëdeklarim**tësipërfaqesqë ka nëpërdorimpranëdrejtorisëpërkatestëBashkisë.

b- **Niveli**iTaksësmbiTruallincaktohetnëlekëpërmetërkatrornëvite

| Klasifikimi i Bashkive | Çmimi Referues, për qëllime banimi | Çmimi Referues. për qëllime Biznesi |
|---|---|---|
| Bashkia Kuçovë | 0.42 lekë/m2/vit | 18 leke/m2/vit |

Detyrimi i kësaj takse është vjetor dhe llogaritet si shumëzim i nivelit te taksës me sipërfaqen që disponohet nga pronarët apo perdoruesit.

Taksa e truallit ,paguhet në buxhetin e bashkise, ne territorin e se ciles ndodhet prona, sipas afateve qe propozohen:

- Per abonentet familjar afati **deri 30.09.2025**;
- Per subjekte e biznesit, ndermarje&instituc, afati **30.06.2025**

## *3. TAKSA E FJETJES NË HOTEL*

Kjo Taksë do të aplikohet në zbatim të ligjit nr.142/2015 datë 17.12.2015 neni 13. Ky nen përcakton ndryshimet që bëhen në nenin 26, pika 2 e 3,te ligjit nr.9632 datë 31.10.2006, "Për Taksat Vendore", ndryshime që pasqyrohen në tabelën e mëposhtme

| Nr | Taksa Fjetjes ne Hotel | NjësiaMatëse | Kuçova | Kozare | Perondi | Lumas |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | -Hotele 4-5 yje | Cmimi/fjetjes/klient(lek) | 105 | 105 | 105 | 105 |
| 2 | -Bujtina, fjetina,motel | Cmimi/fjetjes/klient(lek) | 35 | 35 | 35 | 35 |

Detyrimi për Taksën e fjetjes në hotel, llogaritet si shumëzim i nivelit te taksës, vendimuar nga Këshilli i Bashkisë,për natë qendrimi, me numrin e netëve të qendrimit në hotel.
Detyrimi për të paguar këtë taksë i takon klientit që akomodohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga subjekti "hotel", për llogari të Bashkisë, në territorin ku ndodhet hoteli. Në faturën që lëshon hoteli shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të caktohet vlera e kësaj takse.Derdhja e të ardhurave për këtë taksë, bëhet nga subjekti "hotel" në favor të Bashkisë **brenda datës 5 të muajit pasardhës.** Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e të Ardhurave, dhe njësitë administrative, në të cilat zhvillohet aktiviteti hotelier.

## 4.*TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË*

Në zbatim të ligjit 9632 datë 30.10.2006,"Për Sistemin e Taksave Vendore" neni 27 pika 2, si dhe ligjit nr 142/2015 datë 17.12.2015, "Për disa ndryshime në ligjin "Për Sistemin e Taksave Vendore" neni 14, niveli i Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, duhet të përcaktohet sipas natyrës së investimit dhe në propozojme qe per vitin 2025, të kemi të njëjtat nivele si në vitin 2024, dhe konkretisht si më poshtë :

| **Taksa e ndikimit në infrastrukturë** | **Njësia matëse** | **KUCOVA** | | **KOZARE** | | **PERONDI** | | **LUMAS** | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **2024** | **2025** | **2024** | **2025** | **2024** | **2025** | **2024** | **202** |
| a.PërprojekteteInfrastruk. | % e vleresinvestimit | 0.1 | 0.1 | 0.1 | 0.1 | 0.1 | 0.1 | 0.1 | 0 |
| b.Ndërtimetëtjera(biznes) | % e vleres se shitjes | 5 | 5 | 5 | 5 | 5 | 5 | 5 | |
| c.Shtëpibanimi | % e vleres se shitjes | 3 | 3 | 3 | 3 | 3 | 3 | 3 | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| d.PërNdërt.nëproces legal. | % e vleres invest | 0.5 | 0.5 | 0.5 | 0.5 | 0.5 | 0.5 | 0.5 | 0 |
| e.Ndërtime për qëllime bujqës, blegt | %vleres preventivii | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 |
| f.Ndërtime funksion prodh industr,material. porositësi | % vleres investimit | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 |

- Baza e taksës së ndikimit mbi infrastrukturë nga ndërtimet e reja është vlera në lekë e investimit te ri që kërkohet të kryhet. Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në perputhje me legjislacionin në fuqi për dhenien e lejes se ndërtimit.
- Ne rastin e ndertimeve për qëllim banimi apo njësi shërbimi nga shoqërite e ndertimit , të cilat nuk destinohen për perdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, niveli i Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, caktohet me vendim të Këshillit Bashkiak ne intervalin 4% deri në 8% te çmimit të shitjes për m2. Baza e taksës është vlera në lekë per m2 e cmimit te shitjes te njesive te sherbimit apo tregtise, si dhe per ato te percaktuar për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për m2, bazohet në vlerën referuese të vlerës sëtregut , sipas percaktimeve në aktet normative të Këshillit të Ministrave.
- Niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit
- Detyrimi për taksën e ndikimit ne infrastrukturë i takon investitorit
- Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për kategoritë :
  - **a,b,c,e dhe f** është Drejtoria e Urbanistikes dhe Planifikimit te Territorit pranë Bashkise Kuçovë, kurse për kategorinë: **d.** është ASHK Kuçovë.
- Për tu pajisur me **Deklaraten Paraprake** Punimeve, ne sistemin on-line të lejeve të ndërtimit, tarifa e shërbimeve të jetë **10 000** lekë.
- Për t'u pajisur me Çertifikatë Përdorimi në sistemin on-line të lejeve të ndërtimit, tarifa e shërbimit të jetë 50 lekë/m2 për objekte me destinacion banimi, dhe 30 lekë/m2 për objekte me destinacion bujqesi, industri, agroturizem etj.
- Per t'u pajisur me Leje për ndryshimin e projektit gjatë zbatimi ne sistemin online te lejeve te ndertimit pagesa do te jete 20 000 leke te reja per cdo aplikim
- 
- Per tu pajisur me akte kontrolli, akte pikëtimi gjatë zbatimit të punimeve, tarifa të jetë 2500 lekë/çdo fazë kontrolli.

**Afatet e pageses**

- Pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë do të bëhet para marrjes së lejes së ndërtimit ,menjëherë pas miratimit. Në rast se subjekti nuk bën pagesën brenda një muaji nga data e zbardhjes së lejes së ndërtimit atëhere shfuqizohet leja e ndërtimit për këtë objekt.

Në rast se objekti për të cilin do të kryhet investimi do të shtrihet në territorin e më shumë së një njësie vendore ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një njësie tjeter vendore, të ardhurat nga Taksa ndahen proporcionalisht midis tyre, në raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës njësi.

## *5.TAKSA MBI KALIMIN E TË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E* PALUAJTSHME

Përvitin 2025, kjotakse, nëzbatimtëNenit 28 tëligjit 9632 datë 30.10.2006, do tëpaguhetngasubjektiqekalontëdrejtën e PronësisembiPasurinë e Paluajtshme para kryerjessëregjistrimitnëpërputhje me aktetligjorenëfuqi.
Kjotakseështë e përcaktuardhezbatohetsipasligjit, nëbazëtëkategorisënëtëcilënështëpërcaktuarBashkiasipasligjittëreformës territoriale.

| Nr. | Kategoria e Ndërtesës | Leke/m2 |
|---|---|---|
| 1 | Për ndërtesa banimi | 100 |
| 2 | Për ndërtesa për tregti&shërbime | 300 |
| 3 | Për ndërtesa te tjera | 200 |

- Baza e Taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë se paluajtshme, është sipërfaqja e ndërtimit , pronësia e të cilës po transferohet.
- Baza e kësaj takse është vlera e shitjes së tyre. Niveli i takses caktohet ne perqindje dhe niveli tregues i kesaj takse eshte 2%.
- Detyrimi tatimor llogaritet si shumezim i nivelit te takses me bazen e saj. Taksa paguhet nga personi qe kalon te drejten e pronesise mbi pasurine e paluajtshme

1. Përjashtohen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:
   a) Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe Organet e Qeverisjes Qendrore e Vendore;

   b) Personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr. 8438/1998 *"Për tatimin mbi të ardhurat";*

   c) Subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:

   d) Institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;

   e) Bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga Këshilli Bashkiak për përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

2. Në rastet kur pranohet nga vetë palët ose kur vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohen taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera sipas ligjeve në fuqi.

Agjenti tatimor

**Agjenti Tatimor** per vjeljen e kesaj Takse do te jete Zyra Vendore e Regjistrimit te Pasurise se Paluajtshme, e cila perfiton **3% te** vleres se arketuar.

**Afatet e Pageses**

Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise, paguhet nga personi qe i kalon e drejta e pronesise para kryerjes se regjistrimit.Te ardhurat nga kjo takse derdhen per llogari te buxhetit te bashkise ne territorin e se ciles ndodhet pasuria, **jo me vone se data 30 e muajit pasardhes**

## ***6.TAKSA E TABELES***

1) Taksa e tabelës aplikohet për të gjithë subjektet të cilët vendosin emërtimin e tyre në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike ose private, qofshin këto të lëvizhshme ose të palëvizshme.
2) Taksa e tabelësaplikohet për tre lloje tabelash, të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe mënyrës së vendosjes së tyre:
   a) *Tabela për qëllime identifikimi,* të cilat janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi. Tabelat me sipërfaqe më të vogël se 2 m² nuk taksohen.
   b) *Tabela për qëllime reklamimi (të lëvizshme apo të palëvizshme)*, ku përfshihen tabelat që nuk janë brenda territorit të biznesit ose nuk janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës, dhe që mund të jenë të thjeshta ose elektronike. Ato vendosen në pamje jo ballore, në tarraca, llozha, ballkone, në pjesë të rrugës, shtylla etj., që kanë përmbajtje dhe qëllime reklamimi për vetë ose për palë të treta. Ato mund të jenë tabela të thjeshta (të lëvizshme dhe të palëvizshme) ku përfshihen të gjitha reklamat statike, ndiçuese ose jo ndriçuese, faqet murale dhe autolëvizëse dhe të gjitha reklamat e lëvizshme me fletë, pamje dy ose tre vizionëshe, elektromekanike ose pa ndriçim, faqet murale dhe autolëvizëse; tabela elektronike (të lëvizshme dhe të palëvizshme) ku përfshihen reklamat dixhitale, lineare me të gjitha elementët gjysëm përçues etj..
   c) *Tabela për qëllime ekspozimi*, ku përfshihen tabelat me karakter të përkohshëm, përekspozime të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.
3) Taksa e tabelës paguhet për çdo njësi ku subjekti zhvillon aktivitetin nga muaji korrent që regjistrohet pranë QKB.
4) Vendosja e tabelës për **qëllim identifikimi** është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulantëve dhe subjekteve që ushtrojne profesionet e lira.

Per vitin 2025, kjo takse eshte percaktuar, ne zbatim te ligjit nr. 9632, date 30.10.2006, "Per sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar me ligjin nr.10354 date 18.11.2010, neni 3, aneksi 7, si me poshte :

| Nr. | Llojet e Tabelave | Nj/Matese | B. Kucove |
|---|---|---|---|
| 1. | Takse Tabele me qellim identifikim trupezuar ose jo, brenda territorit te biznesit, jo per reklame | | |
| a. | Deri ne 2m2 | Leke/m2/vit | 0 |
| b. | Mbi 2m2 deri 10m2 | | |
| | -E thjeshte (pa ndricim) | Leke/m2/vit | 7000 |
| | -Me ndricim te thjeshte | Leke/m2/vit | 11500 |
| | -Elektronike | Leke/m2/vit | 15000 |
| c. | Mbi 10m2 deri ne 20m2 | | |
| | -E thjeshte(pa ndricim) | Leke/m2/vit | 5950 |
| | -Me ndricim te thjeshte | Leke/m2/vit | 9775 |
| | -Elektronike | Leke/m2/vit | 12750 |
| d | Mbi 20m2 deri ne 40m2 | | |
| | -Ethjeshte pa ndricim | Leke/m2/vit | 3850 |
| | -Me ndricim te thjeshte | Leke/m2/vit | 6325 |
| | -Elektronike | Leke/m2/vit | 8250 |
| e. | Mbi 40m2 | | |
| | -E thjeshte pa ndricim | Leke/m2/vit | 2800 |
| | -Me ndricim te thjeshte | Leke/m2/vit | 4600 |
| | -Elektronike | Leke/m2/vit | 6000 |
| 2. | Tabela me qellim orientimi, jashte territorit ku zhvilohet veprimtaria e biznesit | | |
| | -Tabele Identifikuese | Leke/m2/vit | 120 |
| 3. | Tabele me qellim reklamimi e levizshme,ose jo deri ne 35 m2 | | |
| | -E thjeshte pa ndricim | Leke/m2/vit | 13500 |
| 4. | Tabela ne funksion te ekspozitave te hapura, panaire,spektakle, stenda reklamuese etj | | |
| | -Te gjitha llojet dhe permasat | Leke/m2/vit | 1000 |

Struktura e ngarkuar per dhenie leje per te vendosur tabele reklamuese eshte **Drejtoria e Planifikimit te Territorit,**prane bashkise Kucove, bazuar ne kerkesen e subjektit qe do te vendose tabelen reklamuese

Kjo Tarife do te vilet nga drejtoria e te Ardhurave te Bashkise Kucove, per bizneset sipas afateve te caktuar, ndersa per **kategorine III,** ne momentin e dhenies per leje te ekspozites spektakle etj

**Afati i Pageses**

Per subjektet e biznesit te vogel, afati i pageses do te jete **deri 30 Qershor 2025.**
Per subjektet e biznesit te madh, afati i pageses do te jete deri ne **30 Qershor 2025.**
Per Ndermarrjet dhe Institucionet, afati i pageses do te jete deri ne **30 Qershor 2025.**

Per subjektet e transportit te udhetareve apo transport mall per vete e te trete ne **momentin** e pajisjes me certifikate perkatese
Per subjektet e reja pagesa e kesaj do te behet ne momentin e regjistrimit.

**Menyra e Pageses**

Takses se Tabeles i nenshtrohen te gjithe subjektet juridik vendas dhe te huaj ndermarrje dhe institucione ne juridiksion te Bashkise Kucove dhe paguhet se bashku me taksat dhe tarifat e tjera lokale.

## 7. ***<u>TAKSA E DHENIES SE LICENCAVE PER TREGTIMIN E NAFTES BRUTO DHE NENPRODUKTEVE TE SAJ</u>***

Bazuar ne ligjin nr.8450 date 24.02.1999 "Per Perpunimin, Transportimin dhe Tregtimin e Naftes, Gazit dhe Nenprodukteve te tyre", ndryshuar me ligjin 9218 dt.08.04.2004 "Per disa shtesa e ndryshime ne ligjin nr.8450 si dhe VKM nr.129 dt.18.03.1999 "Per Procedurat dhe Kushteve per Dhenien e Lejeve e te Autorizimeve per Tregtimin s Naftes, Gazit e nenprodukteve te tyre" te ndryshuar me VKM nr.170 dt.25.04.2002 dhe nr.563 dt.27.08.2004, "Per disa shtesa dhe ndryshime per procedurat dhe kushtet per dhenien e lejeve dhe te autorizimeve per tregtimin e naftes bruto dhe nenproduketeve te saj", VKM nr.970 dt.02.12.2015 "Per percaktimin e procedurave dhe kushteve per dhenien e licencave per tregtimin e naftes bruto dhe n/produketeve te saj", ndryshuar me VKM nr.344 dt.19.04.2017 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne VKM nr.970 dt.02.12.2015", bashkia jep licence per personat juridike te cilet ushtrojne veprimtarine e tyre per tregtimin e karburanteve per automjete dhe per shitjen e lendeve djegese ne territorin e bashkise Kucove.

- Autorizimet jepen nga bashkia per nje periudhe **deri ne 5 vjet** me te drejte perseritje dhe pagesa per dhenien autorizimi per dy kategorite e mesiperme eshte si vijon:

**Tarifë për dhënie licenca për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj**

1- Dhënie dhe përsëritje e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet,dhe vajrave lubrifikante **1 000 000 Lekë/liçencë 5 vjecare**

2- Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse,për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë **100 000 Lekë/liçencë 5 vjecare**

- Pagesa te kryhet ne menyre perpjestimore: 1/5 e Tarifes para marrjes se licences, dhe cdo fillim viti pasardhes nga 1/5 deri ne realizim te tarifes se plote. .

Struktura e ngarkuar per dhenien e kesaj licence dhe vjeljen e detyrimit eshte **Drejtoria e Sherbimit Publik&Transportit.**

Struktura e ngarkuar per penalitetet dhe per masat shtrenguese per detyrimin e pajisjes me licence dhe pageses me force, **eshte Policia Bashkiake**

## 8. RENTA MINERARE

Ne mbeshtetje dhe ne respekt te ligjit nr.9975, dt. 28.07.2008 "Per Taksat Kombetare" i ndryshuar, ne zbatim te Udhezimit te Ministrise Financave nr.26 date 04.09.2008, "Per Taksat Kombetare ne R.Sh." i ndryshuar, paragrafi 2.5, te Ligjit nr.68/2017, date 27.04.2017, "Per Financat e Veteqeverisjes Vendore", neni 25, pika 1 dhe pika 2.c ,njesite e qeverisjes vendore ne te cilat ushtrohet aktiviteti i shfrytezimit te tokes dhe nentokes per nxjerrjen e hidrokarbureve apo dhe mineraleve, perfitojne nga ndarja e Rentes Minerare ne **masen 5 %.**

- Agjentet Fiskale per faturimin, arketimin dhe alokimin e pjeses qe i takon njesive vendore, jane Drejtorite Rajonale Tatimore, si dhe Deget e Doganave.

- Struktura pergjegjese per ndjekjen dhe realizimin e kesaj te ardhure, nga ndarja e takses kombetare, eshte Drejtoria e te Ardhurave.

- Bazuar ne Udhezimin nr.26 date 04.09.2008 te Ministrise se Financave,"Per Taksat Kombetare" i ndryshuar, Drejtoria e te Ardhurave, cdo fund muaji, ben rakordimin me Drejtorite Rajonale Tatimore apo dhe Deget e Doganave duke firmosur formularin respektiv ligjor dhe kerkon prej strukturave pergjegjese alokimin e te ardhurave nga Renta Minerare.

## 9. TE ARDHURA NGA TATIMI MBI TE ARDHUART PERSONALE

Te ardhurat nga Tatimi mbi te Ardhurat Personale eshte detyrim ligjor dhe financiar i Drejtorise Rajonale Tatimore, ku perfshihet bashkia jone, per te arketuar, mbledhur dhe me pas shperndare sipas dispozitave ligjore, Tatimin mbi te Ardhurat Personale.

Ne zbatim te ligjit nr.9975 date 28.07.2008 "Per Taksat Kombetare ne R.Sh.", Ligjit nr. 68/2017 date 27.04.2017 "Per Financat e Veteqeverisjes Vendore", neni 25 pika 1 dhe pika 2.ç, njesite e qeverisjes vendore, perfitojne **2 %** te te ardhurave nga Tatimi mbi te Ardhurat Personale.

12. Tarife per leje aktiviteti non – stop;
13. Tarifa Vendore Per Mirembajtjen e Kanaleve Kullues
14. Tarifa Vendore për Vaditjen;
15. Tarifa e Sherbimit Zjarrfikes;
16. Tarifat e frekuentimit te Kopshte&Cerdheve
17. Qerate e Tokes Bujqesore e Pyjore
18. Tarifa të shërbimit administrativ;
19. Tarifa per shfrytezimin e linjave ajrore e nentokesore per operatoret telefon&internet
20. Tarifa e perkohshme per ndotje mjedisi
21. Tarifa e Mirembajtjes Varrezave

## 1.TARIFA PER ZENIEN E HAPESIRAVE PUBLIKE

Tarifa per zenien e perdorimin e hapesirespublike , ne zbatim te ligjit 9632 date 30.10.2006, « Per Sistemin e TaksaveVendore « , neni 32, eshte e percaktuar ne masen 80 leke/m2/muaj per vitin 2024, me te drejten e korrektimit te ketijniveli per njesite administrative periferike. Pageses se kesaj Tarife i nenshtrohen te gjitha subjektet qe administrojne hapesire publike per interesat e biznesit te tyre ne te gjithe shtrirjen territoriale te bashkise Kucove.

| **Takse per zeniete HapesiresPublike** | **Njesia matese** | **KUCOVA** | | | **KOZARE** | | | **PERONDI** | | | **LUMAS** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **2024** | **2025** | | **2024** | **2025** | | **2024** | **2025** | | **2024** | **2025** | |
| | | | **V1** | **V2** | | **V1** | **V2** | | **V1** | **V2** | | **V1** | **V2** |
| **HapesiraPublike** | Leke/m2/muaj | 80 | 85 | 90 | 45 | 50 | 55 | 45 | 50 | 55 | 45 | 50 | 55 |

### Menyra e Pageses

- Periudha e shfrytezimit per HapesirenPublike, per atosubjekteqelidhinkontraten ne fillim te vitit, do te jete **8 ( tete ) muaj** per te gjithanjesite administrative. Per hapesiratpublikeqemiratohengjatevitit do te perdoret formula : 8 / 12 x muajtqevijojne pas lidhjeskontrates

- Baza e Tarifes per zenie te hapesireseshtesiperfaqja ne m2, e cila pas miratimit te kerkeses se subjektitdhelidhjes se kontrates se shfrytezimit, i vihet ne shfrytezimngaindividedhesubjektefizikapojuridike.

- Detyrimi I tarifes llogaritet si shumezim I bazes (siperfaqes) me nivelin e takses dhe me periudhen e caktuar me vendim te keshillit bashkiak

- Per rastin e perdorimit te siperfaqeve publike me qellim organizimin e spektakleve ose panaireve te ndryshme, fillimisht subjekti I interesuar duhet te paraqes prane bashkise , kerkesen per shfrytezimin e saj, objektin e veprimtarise dhe kohen e shfrytezimit.

- Ndalohet zenia e hapesirave publike(trotuare, sheshe, rruge), te cilat nuk jane miratuar me pare nga organi perkates

**Agjenti Tatimor**

Struktura e ngarkuar per vjeljen, arketimin e kesaj tarife eshte Drejtoria e te Ardhurave, njeheresh Njesite Administrative respektive, per hapesirat qe perdoren nga subjektet individ, fizik apo juridik, ne keto njesi..

**Afatet e Pageses**

- Per kategorine "organizim I spektakleveosepanairevetendryshem", pagesa kryhet **menjehere**, para marrjes se lejes nga Bashkia.
- Pagesa per Zenie te Hapesires Publike, per qellime tregtimi **ne tregjet publike**, do te behet ne respektim te Kontrates se lidhur ndermjet institucionit te bashkise dhe subjektit tregtar, **brenda dates 20 te cdo muaji.**
- Per kategorine, perdorim I Hapesires Publike per qellime tregtimie sherbimi, nga subjekte dhe entet e biznesit, do te percaktohet me Rregullore qe duhet miratuar nga Keshilli Bashkiak, dhe pagesa kryhet **ne momentin e lidhjes se marreveshjes** midis Bashkise dhe subjektit kerkues.
-

**MenyrasiVeprohet**

Subjektifizik apo juridik I interesuar per perdorimtesiperfaqespublike per **qellimebiznesi**, paraqetkerkesendheperiudhen( ecilaeshtecaktuar**8 muaj**), pranedrejtorise se PlanifikimitdheZhvillimitteTerritorit ne bashki. Me marrjen e lejes se shfrytezimitngaKomisioni per HapesirenPublike pas miratimitteplanvendosjes se berengaDrejtoria e PlanifikimitteTerritorit, subjektilidhkontraten me drejtorine e teArdhurave me afatin e percaktuar me vendimtekeshillitbashkiak.

Struktura e ngarkuar per **adresimin** e kerkesavedheshqyrtimittetyreeshteDrejtoria e PlanifikimitteTerritorit ne bashkineKucove, struktura per **kontraten,** pas miratimittekerkeseseshteDrejtoria e teArdhurave. Ne rastteshmangievedhemospagimittekesajtarifezbatohenmasatshtrenguesetesanksionuara ne ligj.

## 2. TARIFA E SHERBIMIT VETERINAR

Tarifa e Therjes eshte tarife qe vilet ne subjekte "thertore" per cdo kafshe te therrur sipas kategorive te klasifikimit te gjese se gjalle.

Bazuar ne Urdherin nr.451 date 24.10.2017, "Per koordinimin e punes ne kontrollin e therjes se kafsheve dhe tregtimit mishit te tyre" te Ministrise se Bujqesise, si dhe shkreses nr.5302 date 07.12.2017 te A.K.U-se,jane pezulluar te gjitha thertoret dhe aktualisht nuk funksionojne. Kjo eshte arsyeja qe arketimi i kesaj tarife eshte reduktuar duke u zeruar.

